



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 907/6 prot.

Datë: 27.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 551/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.04.2026 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur. (Shërbime)”, me nr. REF-79275-03-13-2026, me objekt “Shërbim printimi”, me fond limit 12 399 500 (dymbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 02.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Albcontrol.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur. (Shërbime)”, me nr. REF-79275-03-13-2026, me objekt “Shërbim printimi”, me fond limit 12 399 500 (dymbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 02.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Albcontrol

**Ankimues:** Operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK, me Nipt. L92713601Q dhe adresë Lagjja 18 Shtatori, rruga Xhorxh Sorros, nr. 1524, Gjirokastër

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me Nipt.J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durës, Km 8, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Albcontrol.  
Rinas, Tiranë (P.O.Box 8172).

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.03.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur. (Shërbime)”, me nr. REF-79275-03-13-2026, me objekt “Shërbim printimi”, me fond limit 12 399 500 (dymbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 02.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Albcontrol.

II.2. Më datë 25.03.2026 autoriteti kontraktor, Albcontrol ka publikuar në SPE shtojcën për ndryshim të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në datën 24.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6452 dhe me nr. 907/2026 prot., datë 25.03.2026, e operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

*“1.Ne Piken nr 2.3.3 Autoriteti Kontraktor shprehet:*

*Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë në stafin e tij të punësuar këta specialistë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:*

*? Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për ITIL për shërbimet IT.*

*? Të paktën 3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit që O.E. do të ofertojë ;*

*? Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së*

*menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë;*

*? Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për analizim dhe implementimin e Sistemit të menaxhuar të printimeve.*

*Ne lidhje me kete kerkese OE In Print nuk eshte dakort me piken (Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL PER SHERBIMET E ir) pasi certifikata ITIL nuk ndikon ne funksionimin e sherbimit te printimit dhe fotokopjimit .*

*Certifikimi ITIL perqendrohet me shume ne menaxhimin e sherbimeve te IT ne pergjithesi dhe jo ne kryerjen e mirembajtjeve specifike per sherbimin e printimit dhe fotokopjimit sic eshte objekti i kesaj procedure te kerkuar. Ky certifikim prezanton elementet dhe terminologjine ne fokus se si ITSM munde te nxise vleren e biznesit, fokusohet ne planifikimin startegjik dhe permiresimin e vazhdueshem per profesionistet e lidershit te IT me objektiva biznesi.*

*Pasja e specialisteve te certifikuar per kete procedure 1 (nje) punonjes të certifikuar ITIL per sherbimet IT, e gjykojme nje kriter jo te drejte ne raport me sherbimin e kerkuar.*

*Theksojme se keta lloj specialistesh te kerkuar nuk kane te bejne me sherbimin e printimit. Mirembajta nga ana teknike e pajisjeve te operatorit mund te behet fare thjeshte dhe me specialist te cilet kane marre nje trajnim nga kompanite prodhuese te pajisjeve apo institucioneve te autorizuar per to.*

*Ne objektivat e punes per nje specialist te certifikuar me ITIL jane:*

*Shqyrton operacionet në organizatat moderne të IT-së dhe shërbimeve dixhitale. Adreson se si të rritet shpejtësia dhe efikasiteti i rrjedhës së vlerës.*

*Eksploron rolin e parimeve kulturore ose të sjelljes.*

*Përshkruan termat dhe konceptet e përdorura zakonisht në menaxhimin e shërbimeve.*

*Ne asnje nga objektivat e punes te lartepemendura nuk shprehet qe punonjesit marrin njohuri mbi pajisjet e printimit, menyren sesi funksionojne ato, apo njohuri teknike per mirembajtjen e pajisjeve te printimit. Pra njohurite e punonjesve te certifikuar per ITIL, mund te kene te bejne me gjithcka tjeter por jo me mirembajtjen e pajisjeve te printimit .*

*Nisur nga ky shpjegim kerkojme qe certifikatat ITIL te hiqet pasi nuk kane te bejne me mirembajtjen e pajisjeve te printimit te kerkuar ne kete procedure.*

*Ne piken 2.3.3 autriteti kontartor kerkon të paktën 3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë ;*

*Ne kete sherbim kerkohen pajisje meketoo sasi: pajisje A3/A4 me ngjyra 16 cope, pajisje A4 me ngjyra 20 cope.*

*Nisur nga sasite e percaktuara te pajisjeve (pajisje A3/A4 me ngjyra 16 cope, pajisje A4 me ngjyra 20 cope) kerkesa per te patur 3 punonjes te certifikuar nuk eshte ne propocion te drejte me volumin e kerkuar.*

*Kriteri per kerkuar 3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë e konsiderojme abuziv, pasi pengon pjesemarrjen e kompanive te vogla dhe te mesme te cilat deshirojne te marrin pjese ne kete proceduren, dhe per rrjedhoje pengon konkurrencen. Duke patur ne konsiderate qe do tu sherbehet ne total vetem 36*

pajisje printimi, konsiderojme qe 2 (dy) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë eshte ne propocion te drejte me saste e pajisjeve dhe volumin e kerkuar te printimit.

Kerkojme kriteri:3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë te modifikohet ne :2 (dy) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë

Ne lidhje me kriterin :

? Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë;

? Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për analizim dhe implementimin e Sistemit të menaxhuar të printimeve.

shprehim rezervat tona pasi:

- qartasi dhe pa asnje argumentim vendosja e dy kriterëve (Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë/Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për analizim dhe implementimin e Sistemit të menaxhuar të printimeve) ngushton garen e konkurrimit ne kete procedure dhe nuk nxit pjesemarrjen e kompanive te vogla dhe te mesme.

Pasja e nje specialisti per te analizuar sistemin e menaxhimet te printimit e quajme jo te drejte dhe abuziv pasi nuk luan asnje rol, pasi vete platforma e menaxhimit i kryen vete analizat mbi llojet e printimit, sasite e printimit, mbi personelin i cili ka printuar dhe cdo informacion tjeter qe autoriteti ka nevojë, informacion i cili vete platforma e gjeneron cdo muaj apo kurdohere qe autoriteti kontraktor e kerkon.

Prandaj theksojme qe ky kriter nuk eshte ne propocion te drejte dhe i tepert me sherbimin qe kerkohet, kur kete rol e kryen vete platforma e menaxhimit te printimit.

Persa i perket kriterit (Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë) gjykojme qe kete proces per insatlimin se platformes/ose softwarit mund ta kryejne fare mire dhe punonjesit me diplome te larte te shkolles IT/apo shkencave kompjuterike te cilet jane mese te afte per te kryer kete procedure me njohurite qe u jep kjo diplome.

Ju veme ne dijeni qe platforma e menaxhimit apo softwari i menaxhimit blihet nga prodhuesit, dhe per ta implementuar stafi me diplome te larte IT/apo te shkencave kompjuterike jane mese te afte per ta kryer si sherbim pasi vetem do kryejne identifikimin apo vendosjen e kodeve te cilat jepen nga prodhuesi apo zhvilluesi platformes apo softwarit.

Ne perfundim kerkojme modifikimin e kriterit simeposhte:

Ishte:

Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë në stafin e tij të punësuar këta specialistë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

? Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për ITIL për shërbimet IT.

? Të paktën 3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë ;

? Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë;

? Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për analizim dhe implementimin e Sistemit të menaxhuar të printimeve.

*Te behet:*

*Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë në stafin e tij të punësuar këta specialistë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:*

*? Të paktën 2 (dy) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit që O.E. do të ofertojë ;*

*? Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë ose ekuivalente me diplome IT /apo të fushës së IT për implementimin e platformës;*

*Ne kishim me specifikimet teknike të pajisjeve konstatuara :*

*Ne lidhje me shpejtësinë e pajisjeve : pajisja A3/A4 45 faqe/mi, dhe pajisja A4 50 faqe/min konstatuara shpejtësinë e lartë për faqe/min të cilat janë kërkuar. Shpejtësitë e përmendura hyjnë tek kategoritë të pajisjeve me shpejtësi të lartë.*

*Volumi I kërkuar për faqe I kërkuar në ditë është 400.000 A4 me ngjyra dhe 10.000 A3 me ngjyra. Me një përpjestim të theksuar del se :*

*400.000 A4 me ngjyra/vit : 12 muaj : 20 ditë/muaj : 36 pajisje = 46.2 faqe A4 në ditë*

*10.000 A4 me ngjyra/vit : 12 muaj : 20 ditë/muaj : 16 pajisje = 2.6 faqe A4 në ditë*

*Nisur nga nisur nga volumi i printimit 46 faqe për volumin A4 dhe 2.6 faqe në ditë për volumin A3 kërkesa për një shpejtësi të pajisjes A3/A4 - 45 faqe/mi, dhe pajisja A4 - 50 faqe/min është e egzagjeruar, abuzive dhe e paargumentuar teknikisht.*

*Fare mirë këto vëllime mund të printohen dhe pajisjet me një shpejtësi të ulët 20-25 faqe në min.*

*Kërkojmë modifikimin e shpejtësisë së printimit në :*

*pajisja A3/A4 jo më e vogël se 25 faqe/min*

*pajisja A4 jo më e vogël se 25 faqe/min*

*Për pajisjet janë vendosur këto specifikime:*

*për pajisjen A3 kërkojmë:*

*Kapaciteti i letres : jo më e vogël 1.100 fletë Kapaciteti maksimal i hyrjes së letres : 5.100 fletë*

*Nisur nga volumi i printimit prej 46.2 faqe në ditë volumi maksimal i letres prej 5.100 faqe është i paargumentuar, abuziv dhe thjesht për të ngushtuar garën.*

*Duke qenë se kapaciteti i letres është kërkuar 1.100 faqe/në ditë besojmë që është mesazh mjaftueshëm, duke patur një volum printimi prej 46.2 faqe në ditë.*

*Nga sa shpjegojmë me sipër kërkojmë që:*

*Për pajisjen A3 : Kapaciteti maksimal i hyrjes së letres : 5.100 fletë të hiqet pasi është abuziv dhe i paargumentuar teknikisht.*

*për pajisjen A4 kërkojmë:*

*Kapaciteti i letres : jo më e vogël 1.200 fletë Kapaciteti maksimal i hyrjes së letres : 2.300 fletë*

*Edhe për pajisjen A4, nisur nga volumi i printimit prej 46.2 faqe në ditë, volumi maksimal i letres prej 2.300 faqe është i paargumentuar, abuziv dhe thjesht për të ngushtuar garën.*

*Duke qenë se kapaciteti i letres është kërkuar 1.200 faqe/në ditë besojmë që është mesazh mjaftueshëm, duke patur një volum printimi prej 46.2 faqe në ditë.*

*Nga sa shpjeguar me sipër kerkojme qe:*

*Per pajisjen A4 : Kapaciteti maksimal i hyrjes se letres : 2.300 flete te hiqet pasi eshte abuziv dhe i paargumentuar teknikisht.”.*

II.2. Në datën 30.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6462 dhe me nr. 961/2026 prot., datë 30.03.2026, e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

*“Shoqëria “Infosoft Office” SHPK, si një kompani e fushës dhe e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, pasi u njoh me ndryshimet e bëra në dokumentat e tenderit, vlerëson se, këto ndryshime për në një pjesë të specifikimeve teknike duhet të ndryshohen.*

*Më datë 24.03.2026, autoriteti kontraktor, me shtojcën e publikuar në SPE në këtë datë, ka bërë ndryshime thelbësore për sa i përket tipologjisë së pajisjeve të kërkuara, pasi nga një pajisje me tipologji, pra e llojit “Fotokopje/printer/skaner Bardhë e zi” për format letre A4, me shtojcën e datës 24.03.2026 ka kërkuar një pajisje tërësisht të ndryshme e llojit, tipologjisë “FOTOKOPJE/PRINTER/SKANER ME NGJYRA” për format letre A4. Ky ndryshim i bërë nga AK-ja për llojin e pajisjes të kërkuar nga pajisje “BARDH E ZI A4” në pajisje “Me ngjyra A4” është një ndryshim thelbësor pasi, me anë të këtij ndryshimi kërkohet një pajisje tërësisht e ndryshme, pra ka ndryshuar grupi i specifikimeve teknike të pajisjes.*

*Një pjesë e parametrave teknike të kërkuara nga AK-ja për këtë pajisje të re, “FOTOKOPJE/PRINTER/SKANER ME NGJYRA” për format letre A4, janë të ekzagjeruara dhe në kërkojmë që ato të ndryshohen.*

*E konkretisht:*

*Për pajisjen “FOTOKOPJE/PRINTER/SKANER ME NGJYRA” për format letre A4, ndër të tjera AK-ja ka kërkuar edhe plotësimin e parametrave si më poshtë vijojnë:*

#### **5.2.2 PAJISJE SHUMË FUNKSIONALE A4 ME NGJYRA**

*“Funksioni”: Fotokopje/printer/skaner me ngjyra*

*.....*

*Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres = 1200 flete Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres = 2300 flete*

*”*

*Në lidhje me specifikimet teknike të përcaktuar si më sipër, i kundërshtojmë me argumentat si më poshtë vijojnë:*

**SË PARI:**

*Nga ana e shoqërisë tonë edhe në rastin kur AK-ja kishte kërkuar pajisje “FOTOKOPJE/PRINTER/SKANER ME NGJYRA” për format letre A4, i kemi kërkuar AK-së, me anë të një kërkesë për sqarim ti heqë këto parametra pasi, nisur nga volumi i kontratës për këtë lloj pajisje këto parametra janë të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me volumin e printim/fotokopjimeve të kërkuara në DT dhe për më tepër vlerësojmë se këto specifikime/parametra nuk ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit të kërkuar.*

*Në përgjigje të kërkesës tonë për sqarim, AK-ja deklaroi se ka pasur një lapsus nga ana e tyre dhe kanë deklaruar se, ”. kërkesa juaj në këtë rast është e drejtë pasi tek SPECIFIKIMET TEKNIKE*

pika 5.2 është bërë një lapsus në plotësimin e tabelave dhe ne si A.K. do sqarojmë/modifikojmë këtë pikë (5.2.) duke publikuar Shtojcën përkatëse për ndryshimin e Dokumentave të Tenderit (D.T. ”

Sic e argumentuam edhe më sipër mospërcaktimi i saktë i llojit të pajisjes “me ngjyra” apo “bardhe zi”, nuk mund të trajtohet si një lapsus pasi në këtë rast kemi të bëjmë me pajisje tërësisht të ndryshme, pra ndryshimi i bërë nga AK-ja nga pajisje bardh e zi në pajisje me ngjyra e bën kërkesën e AK-së për këto pajisje një kërkesë krejtësisht të re, të ndryshme nga ajo e kërkuar në dokumentat e publikuara të tenderit, pasi operatorët ekonomikë të interesuar do të duhet të sigurojnë dhe të ofertojnë me një pajisje të ndryshme nga ajo e kërkuar me shpalljen e procedurës së prokurimit më datë 17.03.2026.

Konkretisht:

Për pajisjen e kërkuar me shtojcën e datës 24.03.2026 “FOTOKOPJE/PRINTER/SKANER ME NGJYRA” për format letre A4, ku ndër të tjera AK-ja ka kërkuar plotësimin e parametrave si më poshtë vijojnë:

#### 5.2.2 PAJISJE SHUMË FUNKSIONALE A4 ME NGJYRA

“Funksioni”: Fotokopje/printer/skaner me ngjyra

.....

Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres = 1200 flete Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres = 2300 flete

”

Paraqesim kundërshtimet tona si më poshtë:

Sasitë e pritshme për printim, fotokopjim dhe skanim me ngjyra të përcaktuara nga AK-ja janë 400,000 faqe.

Numri total i pajisjeve të kërkuara me ngjyra është 36 pajisje, ku 16 pajisje janë pajisje të cilat printojnë dokumente të formatit A3/A4 me ngjyra dhe 20 pajisje të cilat printojnë dokumente A4 me ngjyra.

Nëse bëjmë një përlllogaritje të thjeshtë, dalim në konkluzionin që secila pajisje do të printojë mesatarisht rreth 46.2 faqe A4 me ngjyra në ditë.

$400,000 \text{ faqe në vit} / 33,333 \text{ faqe në muaj} (400,000 \text{ faqe} / 12 \text{ muaj} = 33,333 \text{ faqe në muaj}) ?$

$1,667 \text{ faqe në ditë} (33,333.333 \text{ faqe në muaj} / 20 \text{ ditë pune në muaj} = 1,666.7 \text{ faqe në ditë}) ?$

$46.3 \text{ faqe në ditë për pajisje} (1,666.7 \text{ faqe në ditë} / 36 \text{ pajisje} = 46.3 \text{ faqe në ditë për pajisje})$

Kapaciteti Standart në Hyrje i Letres i kërkuar nga AK-ja për këtë lloj pajisje është: = 1200 flete, Duke u nisur nga printimi mesatar ditor që do të kryejë secila pajisje, dalim në konkluzionin që me një furnizim letre të pajisjes prej 1200 fletësh, autoriteti ka vendosur në pajisje letër të mjaftueshme për të printuar 25 ditë pune (1200 fletë / 46.29 faqe të printuara në ditë = 25.92? ditë), pra më shumë se një muaj kalendarik.

Nëse bëjmë të njëjtën analizë edhe për Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres = 2300 flete dalim në konkluzionin që me një furnizim të plotë të pajisjes me 2300 fletë, autoriteti ka vendosur në pajisje mjaftueshëm letër për 49.7 ditë pune (2300 fletë / 46.29 faqe në ditë = 49.68? ditë), pra më shumë se 2 muaj kalendarikë.

Për më tepër, mbajtja e letrës të hapur nga ambalazhimi standard i saj për një kohë kaq të gjatë do të krijonte kushte që letra të përthithë lagështi, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e dokumentit të printuar.

Për të gjitha sa më sipër, gjykojmë që kapaciteti hyrës i letrës:

Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres = 1200 flete Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres = 2300 flete

është një specifikim teknik i ekzagjeruar jo në përputhje me objektin dhe volumin e kontrates duke rritur kështu në menyr artificiale kostot e operatoreve ekonomik pjesëmarrës pasi kërkimi I këtyre paramtrave për këtë lloj pajisje ngushton numrin e pajisjeve me të cilat mund të ofertosh në

këtë procedurë prokurimi edhe pse nisur nga volumi I printim/fotokopjimeve të kërkuara nga AK-ja nuk është e nevojshme të kërkohet një pasjije e cila duhet detyrimisht të plotësojë edhe parametrat:

Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres: = 1200 flete Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres: = 2300 flete

Pra, kërkesa si më sipër, sjell kufizim të paargumentuar të pajisjeve me të cilat OE-të mund të ofertojnë në këtë procedurë prokurimi.

Për gjitha sa me sipër, kërkojmë që të behen ndryshime ne specifikimet teknike si me poshte :  
**ISHTE**

Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres = 1200 flete Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres = 2300 flete

**BEHET**

Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres = 600 flete

Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres = 1150 flete

Gjykojmë që kapaciteti standard i letrës prej 600 fletësh është mëse i mjaftueshëm, pasi me volumin e parashikuar nga institucioni prej rreth 46.2 faqe në ditë, përdoruesit final nuk do t'i duhet ta mbushin pajisjen me letër për 12 ditë pune, pra rreth 2 javë kalendarike.

Për gjithë sa më sipër, kërkojmë pranimin e ankesës dhe në përfundim të saj të vendoset të ndryshohen parametrat teknike të përcaktuara ne shtojcën e datës 24 mars 2026 për pajisjen “FOTOKOPJE/PRINTER/SKANER ME NGJYRA” për format letre A4, si më poshtë vijojnë:

**TË BEHEN:**

Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres = 600 flete

Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres = 1150 flete

*Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.”*

II.4. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresat dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesve.

II.5. Njëpërmjet shkresës nr.1025/3 prot., datë 08.04.2026, të ardhur njëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, protokolluar me tonën me nr. 961/1 prot., datë 08.04.2026 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, mbi ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të saj.

II.6. Njëpërmjet shkresës nr.1025/4 prot., datë 09.04.2026, të ardhur njëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, protokolluar me tonën me nr. 907/1 prot., datë 108.04.2026 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, mbi ankesën e operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të pjesshëm të saj duke pranuar kërkesat si më poshtë:

**3“.....Në përgjigje/sqarim të kërkesës së tretë të O.E. ankimues sqarojmë si më poshtë vijon:**

*Kjo kërkesë e juaj do pranohet në parim duke marrë në konsideratë reduktimin e numrit të punonjësve/specialistëve të certifikuar nga dy në një dhe kërkesa jonë do ndryshohet si më poshtë vijon:*

**2.3.3** *Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë në stafin e tij të punësuar këta specialistë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme*

- *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për ITIL për shërbimet IT.*
- *Të paktën 3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit që O.E. do të ofertojë ;*
- *Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë, i cili do kryejë edhe procesin e analizimit dhe implementimit të sistemit të menaxhuar të printimeve.”*

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “IN PRINT” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Njëpërmjet shkresës nr.1025/4 prot., datë 09.04.2026, të ardhur njëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, protokolluar me tonën me nr. 907/1 prot., datë 108.04.2026 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, mbi ankesën e operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të pjesshëm të saj duke pranuar kërkesat si më poshtë:

**3“.....Në përgjigje/sgarim të kërkesës së tretë të O.E. ankimes sqarojmë si më poshtë vijon:**

*Kjo kërkesë e juaj do pranohet në parim duke marrë në konsideratë reduktimin e numrit të punonjësve/specialistëve të certifikuar nga dy në një dhe kërkesa jonë do ndryshohet si më poshtë vijon:*

**2.3.3** *Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë në stafin e tij të punësuar këta specialistë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme*

- *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për ITIL për shërbimet IT.*
- *Të paktën 3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë ;*
- ***Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë, i cili do kryejë edhe procesin e analizimit dhe implementimit të sistemit të menaxhuar të printimeve.”***

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

*2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.*

*3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:*

- a) *pranimin e plotë të ankesës;*
- b) *pranimin e pjesshëm të ankesës;*

c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5 Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i vendimit të autoritetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të

mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.907 prot., datë 25.03.2026, të operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “IN PRINT” SHPK, për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt – ankimi në të cilin kërkon *heqjen e kërkesës për specialist të certifikuar për ITIL për shërbimet IT dhe uljen e numrit të specialistëve teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë nga 3(tre) në 2 (dy) specialistë*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në kriterin kualifikues të pikës 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

*“2.3.3 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontrates, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë në stafin e tij të punësuar këta specialistë, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:*

- *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për ITIL për shërbimet IT.*
- *Të paktën 3 (tre) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve te printimit që O.E. do të ofertojë ;*
- *Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për instalimin/konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit që OE do të ofertojë;*
- *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për analizim dhe implementimin e Sistemit të menaxhuar të printimeve.*

*Shënim:*

*Një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikatë.*

*Kërkesat e mësipërme duhet të vërtetohen me:*

- *Diplomë/dëshmi kualifikimi sipas profilit,*
- *Kontratë individuale pune të vlefshme,*

*Personeli i mësipërm në momentin e hapjes së ofertave duhet të ketë aktualisht marrëdhënie pune me ofertuesin e vërtetuar kjo me formular E-sig të listëpagesës/ave të deklaruara dhe të firmosura nga inspektorët tatimore.*

*Operatori Ekonomik duhet të deklarojë disponueshmërinë e secilit specialist për t’u angazhuar gjatë gjithë afatit te kontratës.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar dhe renditur i pari duhet të dorëzojë pranë A.K., përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër..”*

III.2.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) autoriteti kontraktor lidhur me përcaktimin e afatit të realizimit të shërbimeve objekt prokurimi, lidhur me vendosjen e kriterit kualifikues të pikës 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 98 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit dhe lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*“Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 4 dhe pika 6 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

*Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

*Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën”*

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

28

*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka 5 detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.*

III.2.6. Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*“1 Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve*

ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.7. Referuar Nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 1, 2 dhe pika 4, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”

III.2.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga

operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.2.12.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, ku kërkohet që autoriteti kontraktor të heqë kërkesën për disponimin nga ana e operatorit ekonomik ofertues në stafin e tij të 1 (një) specialisti të certifikuar për ITIL për shërbimet IT, duke e konsideruar nje kriter jo të drejtë në raport me shërbimin e kërkuar pasi certifikata ITIL nuk ndikon në funksionimin e shërbimit të printimit dhe fotokopjimit, referuar procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesën për disponimin nga ana e operatorit ekonomik ofertues në stafin e tij të 1 (një) specialisti të certifikuar për ITIL për shërbimet IT, duke u mbështetur në përcaktimet e të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në përcaktimet e nenin 41 pika 4 dhe pika 6 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndërkohë që përcaktimin e disponimit të 1 (një) specialisti të certifikuar për ITIL për shërbimet IT nuk e ka argumentuar teknikisht, lidhur me nevojën e disponimit të një specialisti me një kualifikim profesional të tillë për realizimin e shërbimeve objekt - prokurimi, referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës së këtyre shërbimeve.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se bazuar në kompleksitetin dhe volumin e kontratës objekt - prokurimi, si dhe specifikimet teknike dhe termat e referencës së shërbimeve objekt prokurimi, kërkesa për disponimin nga ana e operatorit ekonomik ofertues në stafin e tij të 1 (një) specialisti të certifikuar për ITIL për shërbimet IT është një kërkesë e paargumentuar në raport me natyrën e shërbimeve objekt prokurimi. Certifikata ITIL (Information Technology Infrastructure Library) shërben për të vërtetuar njohuritë në menaxhimin e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) sipas standardeve ndërkombëtare alternativë e së cilë në këtë procedurë prokurimi është kërkesa nga ana e autoritetit kontraktor për certifikatat ISO 9001: 2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” dhe ISO 20000-1:2018 “Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve”.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) specialisti të certifikuar për ITIL për shërbimet IT, është një kërkesë e paargumentuar teknikisht nga ana e autoritetit kontraktor, ndaj ky i fundit duhet të modifikojë pikën 2.3.3 të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke e hequr kriterin kualifikues për disponimin nga ana e

operatorit ekonomik ofertues në stafin e tij të 1 (një) specialisti të certifikuar për ITIL për shërbimet IT.

**Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit për këtë pikë qëndron.**

III.2.12.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, ku kërkohet që autoriteti kontraktor të ulë kërkesën për numrin e specialistëve teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit që O.E. do të ofertojë, duke kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë të punësuar në stafin e tij 2 (dy) specialist teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit, pasi kërkesa për 3 të tillë është abuziv, pasi pengon pjesëmarrjen e kompanive të vogla dhe të mesme të cilat dëshirojnë të marrin pjesë në këtë procedurë, dhe për rrjedhojë pengon konkurrencën. Duke patur në konsideratë që do të shërbehet në total vetëm 36 pajisje printimi, konsiderojmë që 2 (dy) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit që O.E. do të ofertojë është në propozicion të drejtë me sasinë e pajisjeve dhe volumin e kërkuar të printimit. Referuar procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesën për kualifikimin e specialistëve teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit, duke u mbështetur në përcaktimet e të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në përcaktimet e nenit 41 pika 4 dhe pika 6 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndërkohë që përcaktimin e numrit të këtyre specialistëve nuk e ka argumentuar në raport me sasinë e shërbimeve objekt - prokurimi dhe në raport me kohën e realizimit të tyre.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se bazuar në kompleksitetin dhe volumin e kontratës objekt-prokurimi, kërkesa për disponimin nga ana e operatorit ekonomik ofertues në stafin e tij të 3 (tre) specialistëve teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit është një kërkesë e paargumentuar në raport me sasinë e shërbimeve objekt prokurimi dhe në raport me kohën e realizimit të tyre, si dhe është e ekzagjeruar dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, pasi objekt i kësaj kontrate është ndërtimi i një sistemi elektronik për administrimin e të dhënave identifikuese dhe mjekësore të kafshëve endacake.

Akoma më tej, qoftë në argumentet e publikuara nga autoriteti kontraktor në procesverbalin e argumentimit të vendosjes së këtij kriteri objekt-ankimimi, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të justifikojë teknikisht dhe ligjërish përcaktimin e numrit të këtyre specialistëve. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të 3 (tre) specialistëve teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit, është një kërkesë e paargumentuar teknikisht nga ana e autoritetit

kontraktor, ndaj ky i fundit duhet të modifikojë dokumentet e tenderit, duke e ulur kërkesën për disponimin nga ana e operatorit ekonomik ofertues në stafin e tij të 3 (tre) specialistëve teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit dhe duke kërkuar 2 (dy) specialist teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit.

**Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit për këtë pikë qëndron.**

III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “IN PRINT” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK mbi modifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve kompjuterike për artikujt objekt prokurimi”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të ndryshuar me shtojcën e datës 25.03.2026, autoriteti kontraktor për artikujt objekt prokurimi ka përcaktuar specifikimet teknike, si më poshtë:

## 5.2 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PAJISJEVE TË PRINTIMIT/FOTOKOPJIMIT



5.2.1 Pajisje shumë funksionale A3/A4 me ngjyra	
“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥45 ppm
Ekрани	≥7 inch,
Rezolucioni I Printimit	≥1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesione ne mm (WxDxH)	≤ 620 x 760 x 880 mm
Ekрани	≥ 7 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A3, A4
Memoria	≥ 4 GB
Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres	≥ 1100 flete
Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres	≥ 5100 flete

Kapaciteti mbajtes se SPDF/DADF	≥ 100 flete
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity“:	≥ 400 flete

### 5.2.2 Pajisje shumë funksionale A4 me ngjyra

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner <b>me ngjyra</b>
<b><i>Shpejtësia “Kopje/Print per A4</i></b>	<b>≥ 50 ppm</b>
Rezolucioni I Printimit	≥ 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesione ne mm (WxDxH)	≤ 510 x 535 x 650 mm
Ekрани	≥7 inch
Formati i letrës “Media sizes”:	A4
Memoria	≥ 2 GB
<b><i>Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres</i></b>	<b>≥ 1200 flete</b>
<b><i>Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres</i></b>	<b>≥ 2300 flete</b>
Kapaciteti mbajtes se SPDF/DADF	≥ 50 flete
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity“:	≥ 300 flete

Ndërsa në shtojcën 8 “Formulari i termave të refernces” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

### **SPECIFIKIME TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E PRINTIMIT**

#### **1. Qëllimi i Shërbimit**

Shërbimi i Menaxhimit të Printimit (Managed Print Services – MPS) përfshin zgjidhjet dhe shërbimet e integruara për menaxhimin efikas të infrastrukturës së printimit në Albcontrol. Qëllimi i këtij shërbimi është të ofrojë një zgjidhje të centralizuar dhe efikase për menaxhimin e

procesit të printimit të akomoduar më shërbim qera të ofruar nga operatorët ekonomik, duke reduktuar kostot operative, duke optimizuar përdorimin e pajisjeve të printimit dhe duke garantuar sigurinë e dokumenteve dhe të dhënave.

## **2. Situata Aktuale e Shërbimit të Printimit në Albcontrol**

### *2.1 Gjendja e pajisjeve:*

#### *a) Pajisje Jashtë Pune*

*Pajisjet jashtë pune nuk kryejnë asnjë funksion. Gjendja e tyre është tejet e amortizuar, duke bërë që riparimi i tyre të jetë shumë i vështirë dhe me kosto të lartë. Disa prej tyre janë në një gjendje kaq të keqe sa që riparimi është i pamundur. Duke marrë parasysh koston e lartë dhe vështirësitë teknike të riparimit, sugjerojmë që këto pajisje të mos riparohen dhe të merren në konsideratë për zëvendësim të plotë.*

#### *b) Pajisje me Probleme Teknike që Kanë Nevojë për Asistencë*

*Nga analizimi i detajuar, i pajisjeve MFP (Multi-Function Printer) kanë nevojë për servis. Shumica prej tyre kërkojnë shërbim teknik të plotë, përfshirë ndërrimin e komponentëve të rëndësishëm si cilindra, furra, goma, etj. Riparimi i këtyre pajisjeve do të kishte një kosto të konsiderueshme dhe gjendja e tyre teknike nuk ofron garanci që pas riparimit ato do të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe me performancë të kënaqshme. Prandaj duhet të konsiderohet zëvendësimi i tyre.*

#### *c) Pajisje në Gjendje Pune*

*Pajisjet rezultojnë të jenë në gjendje pune nuk kane pa probleme teknike të dukshme, por edhe këto pajisje janë të amortizuara dhe kanë vite të tëra që janë në përdorim. Edhe pse aktualisht funksionojnë, është e paqartë për sa kohë do të vazhdojnë të punojnë pa ndonjë ndërprerje ose problem. Këto pajisje kanë pësuar riparime të ndryshme ndër vite dhe janë ndruar pjesë të ndryshme. Për të siguruar vazhdimësinë e punës dhe për të shmangur ndërprerjet e papritura është e dobishme të planifikohet zëvendësimi i këtyre pajisjeve me modele më të reja dhe më të qëndrueshme.*

### *2.2 Shërbimi në tërësi*

*Gjendja e shërbimit të printimit në tërësinë e tij nuk është në nivelin e kërkuar dhe të nevojshëm për të siguruar që stafi të kryejë detyrat e tij pa probleme, me efikasitet dhe me kosto të arsyeshme*

*Aktualisht, infrastruktura e printimit në institucion përbëhet nga një numër i madh pajisjesh të markave të ndryshme, kryesisht KonicaMinolta dhe Xerox, të shpërndara në mënyrë jo të standardizuar nëpër njësitë organizative mbi bazën e nevojave specifike të përdoruesve, por janë vendosur në mënyrë spontane pa marrë parasysh volumin specifik të printimeve për secilën zyrë apo nevojat për shërbime shtesë. Kjo mungesë përshtatjeje sjell një përdorim jo efikas të pajisjeve dhe rrit kostot operationale. Furnizimi me material konsumi, si toner dhe*

*pjesë këmbimi, realizohet në mënyrë të pa organizuar dhe pa planifikim të qëndrueshëm, shpesh herë me ndërprerje dhe mungesë të materialeve. Aktualisht, nuk ekziston një sistem që monitoron dhe menaxhon shërbimin e printimit duke krijuar vështirësi në krijimin rregullave të një printimi të sigurtë që orientojnë stafin drejt reduktimit të printimeve të panevojshme. Gjithashtu Albcontrol nuk ka një shërbim printimi që garanton sigurinë e dokumenteve kur bëhet fjalë për paisje qendrore që përdoren nga disa përdorues. Personeli i IT-së, shpesh angazhohet me probleme teknike për të cilat nuk janë të trajnuar. Kjo situatë vështirëson punën e stafit të IT-së dhe i privon ata nga koha e nevojshme për të kryer detyrat e tyre profesionale në përditshmëri. Për të gjitha arsyet e mësipërme është i nevojshëm implementimi i një shërbimi me paisje me qira sëbashku me mirëmbajtjen, ndërrimin e materialeve të konsumit, instalim dhe Konfigurim i Sistemit të Menaxhuar (MPS) nga një kompani e certifikuar për ofrimin e sistemeve dhe paisjeve të printimit duke ofruar një zgjidhje për shumë nga këto probleme, duke siguruar një shërbim më efikas, me kosto të ulët dhe më të sigurt për institucionin.*

### **3. Objekti i Kontrates**

*Nëpërmjet këtij projekti, synohet sigurimi i kushteve normale të punës për punonjësit e administratës dhe operacionalit, nëpërmjet ofrimit të një shërbimi cilësor e të vazhdueshëm, të printimit, fotokopjimit dhe skanimit të materialeve shkresore, sipas përcaktimeve që janë bërë në këtë dokument, duke eliminuar problematikat e shumta të gatishmërisë së tyre për shkak të defekteve të ndryshme dhe mungesës apo cilësisë së ulët të materialeve të konsumit (tonerëve) që qarkullojnë shpesh në treg. Gjithashtu, nëpërmjet një software të centralizuar sipas kërkesave të cituara në vijim, synohet të arrihet menaxhim i centralizuar i pajisjeve, ndjekje, matje, monitorim, parandalim i qasjeve të paautorizuara në procesin e printimit, fotokopjimit dhe skanimit të dokumentacionit nga pajisjet e zyrës për printim, fotokopjim, skanim që do të përdoren për realizimin e këtij shërbimi, karakteristika këto që mundësojnë kontrollin e kostos, rritjen e efikasitetit dhe komunikimit më të mirë, duke reduktuar rrezikun dhe duke ndihmuar për të përmbushur standartet më të larta të pajtueshmërisë dhe vazhdimësisë së punës.*

*Konkretisht, nëpërmjet këtij projekti duhet të realizohen:*

- *Furnizimi (vënia në dispozicion) me pajisje printimi/fotokopjimi dhe skanimi sipas kërkesave në këtë dokument; instalimi dhe realizimi i konfigurimeve të nevojshme në rrjetin e institucionit; rialokimi (zhvendosja) e pajisjeve sipas nevojave në institucion përgjatë kohëzgjatjes së shërbimit.*
- *Shërbimi i mirëmbajtjes për të gjitha pajisjet ekzistuese, riparimi i defekteve në çdo kohë, zëvendësimi e pjesëve konsumuese vetëm origjinal ose ekuivalente (toner/bojëra origjinale ose ekuivalente, drum origjinal ose ekuivalente, rula të ndryshëm, dhe çdo pjesë këmbimi tjetër e nevojshme për vijueshmërinë e punës dhe nevojave të pajisjeve sipas standarteve të prodhuesve)*

*përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit.*

- *Garantimi i furnizimit të pandërprerë me tonera/bojëra original ose ekuivalente dhe pjesëve të tjera të konsumueshme origjinal ose ekuivalente e të të gjitha pajisjeve që duhet përdoren, (sipas SLA të parashikuar në këtë dokument).*
- *Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të qendëruar për menaxhimin e printimit në pajisjet e Albcontrol. Realizimi i instalimit dhe konfigurimit të tyre në infrastrukturën ekzistuese në institucion (sistem i virtualizuar).*
- *Kalimi i njohurive të stafit IT për menaxhimin e pajisjeve me anë të Software të instaluar.*

#### **4. Vendi i kryerjes së shërbimeve dhe sasitë**

*Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekt i këtij shërbimi, janë:*

##### **Godinat e Albcontrol**

##### **4.1 Sasitë e shërbimit**

*Kontraktori duhet të plotësojë shërbimin për sistemin e printimit sipas të dhënave të mëposhtme:*

<i>Nr</i>	<i>Përshkrimi i Shërbimeve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia e pritshme (për 12 muaj)</i>	<i>Afati</i>
<i>1</i>	<i>Shërbim printimi/fotokopjimi dhe skanimi A4 – Me ngjyra</i>	<i>faqe</i>	<i>400,000</i>	<i>36 muaj</i>
<i>2</i>	<i>Shërbim printimi/fotokopjimi dhe skanimi A3 – Me ngjyra</i>	<i>faqe</i>	<i>10,000</i>	

**Sqarim:** *Kontraktori është përgjegjës vetëm për realizimin e shërbimit të printimit.*

*Letra e nevojshme për realizimin e printimeve dhe fotokopjimeve do të sigurohet dhe vihet në dispozicion nga Albcontrol sipas standarteve të cilësisë.*

#### **5. Kërkesat Teknike**

##### **5.1 Sistemi i Menaxhimit të Printimit duhet të sigurojë:**

*Softueri i menaxhimit të printimit duhet të instalohet në infrastrukturën ekzistuese të institucionit, për të garantuar sigurinë e informacionit dhe humbjen e të dhënave. Sistemi duhet të kryejë funksionet si më poshtë:*

- a. Kontroll i detajuar i aksesit për print, kopjim dhe skanim me PIN, username/password dhe të mundësojë përdorimin e kartave ID/NFC
- b. Politika printimi me quota, limitime, dhe menaxhim kostosh
- c. Auditim i plotë i përdorimit dhe raportime të avancuara.
- d. Integrim me sistemet e menaxhimit të identitetit (Active Directory, Azure AD, LDAP)
- e. Skanim direkt në email, folder, ose cloud storage të institucionit
- f. Mbështetje për printim dhe skanim të sigurt (SSL/TLS encryption)
- g. Funksione për përshtatshmërinë dhe mbajtje të arkivave elektronike
- h. Mbështetje për komunikim të enkriptuar TLS 1.2+
- i. Kontroll aksesi bazuar në role dhe politika grupore
- j. Audit log me gjurmim të detajuar të veprimeve të çdo përdoruesi të direktorisë

## 5.2 Specifikimet teknike të pajisjeve të printimit/fotokopjimit

### 5.2.1 Pajisje shume funksionale A3/A4 Me ngjyra

#### 5.2.2 Pajisje shume funksionale A4 Me ngjyra

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥45 ppm
Ekrani	≥7 inch,
Rezolucioni I Printimit	≥1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	SPDF/DADF
Dimesione ne mm (WxDxH)	≤ 620 x 760 x 880 mm
Ekrani	≥ 7 inch, colour touch screen
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A3, A4
Memoria	≥ 4 GB
Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres	≥ 1100 flete
Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres	≥ 5100 flete
Kapaciteti mbajtes se SPDF/DADF	≥ 100 flete

<i>Kapaciteti në Dalje “Output Capacity“:</i>	$\geq 400$ flete
<i>“Funksioni“:</i>	<i>Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi</i>
<i>Shpejtësia “Kopje/Print per A4</i>	$\geq 50$ ppm
<i>Rezolucioni I Printimit</i>	$\geq 1200 \times 1200$
<i>Vendosja e dokumentit “Document Feeder“:</i>	<i>SPDF/DADF</i>
<i>Dimesione ne mm (WxDxH)</i>	$\leq 510 \times 535 \times 650$ mm
<i>Ekrani</i>	$\geq 7$ inch
<i>Formati i letrës “Media sizes“:</i>	A4
<i>Memoria</i>	$\geq 2$ GB
<i>Kapaciteti Standart në Hyrje te Letres</i>	$\geq 1200$ flete
<i>Kapaciteti Maksimal në Hyrje te Letres</i>	$\geq 2300$ flete
<i>Kapaciteti mbajtes se SPDF/DADF</i>	$\geq 50$ flete
<i>Kapaciteti në Dalje “Output Capacity“:</i>	$\geq 300$ flete

**Sqarim:**

*Dimensionimi W x D x H , jo me i madh se:*

*Për arsye të hapësirës së vogël të zyrave dhe vendosjes së tyre mbi tavolinat e punës kontraktori që do të shpallet fitues duhet të plotësojë dimensionet e paraqitura. Kjo nuk kufizon faktin që mund të pranohen pajisje me dimensione më të vogla.*

- *Kapaciteti mbajtës i sirtareve (jo më i vogël se):*

*Kapaciteti mbajtes i sirtareve eshte gjykuar sipas tipologjise se pajisjes eshte gjykuar qe te vendoset jo me e vogel se, pra eshte vendosur nje minimum por nuk pengohet qe te sillet me kapacitet me te madh.*

- *Kapaciteti ne dalje i syrtareve (jo më i vogël se):*

*Edhe ky specifikim sipas tipologjise së pajisjes është vendosur jo më e vogël se, pra eshte vendosur nje minimum por nuk pengohet qe te sillet me kapacitet më të madh.*

- *Memorja jo me e vogël se :*

Memorja e kërkuar duhet të ofrojë procesim sa më të shpejtë të dokumentave duke mos penguar operatorët e tjerë që janë në pritje. Duke ditur si funksionon një pajisje, atëherë, sa më e madhe të jetë kjo memorje aq më shpejt pajisja është funksionale. Memorja e kërkuar bën të mundur që pajisja të procesojë në një kohë shumë të shkurtër një material në formate të ndryshme, gjë e cila sjell mbarevajtjen në proceset e punëve. Gjithashtu kjo memorje ben te mundur mosbllokimin e pajisjeve gjate printimeve me volum të lartë MB. Një memorje më e vogl rrit mundesine e bllokimit te pajisjes dhe automatikisht pengimin e proceseve të punës.

"Specifikimet teknike janë ndërtuar në përputhje me standardet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me qëllim që të sigurohet ndërveprueshmëri, siguri dhe përputhshmëri me sistemet ekzistuese të administratës publike."

## **6. Buxheti dhe sasitë**

Për të realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kërkohen të lëvrohen, instalohen dhe konfigurohen në ambjentet e Albcontrol komponentët:

- **Pajisje printimi, fotokopjimi dhe skanimi**
- **Materialet e konsumueshme për çdo printer**
- **Komponenti Software (menaxhim dhe**

**monitorim) Sasitë që duhet të lëvrohen:**

<b>Emërtimi</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasi</b>
<i>Pajisje shumë funksionale A3/A4- Me ngjyra</i>	<i>copë</i>	<b>16</b>
<i>Pajisje shumë funksionale A4- Me ngjyra</i>	<i>copë</i>	<b>20</b>

## **Shënim:**

Shpërndarja e pajisjeve duhet realizohet sipas një plani të bashkërenduar pasi nënshkruhet kontrata. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin zgjidhjen e tyre me sasitë e parashikuara për të mbuluar shërbimin.

## **7. KATEGORIZIMI I PROBLEMEVE DHE KOHA E PERGJIGJES**

Shërbimi dhe riparimi i pajisjeve duhet të bëhet me pjesë origjinal ose ekuivalente. Kontraktori duhet të sigurojë një pikë kontakti me Albcontrol dhe të ketë një Helpdesk për të trajtuar të gjitha shqetësimet apo kërkesat për shërbim. Koha e përgjigjes sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Konstatimi, ndërhyrja dhe zgjidhja e problemeve</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Renditja sipas problemit</b>	<b>Koha e Përgjigjes</b>	<b>Koha e zgjidhjes së problemit</b>
<b>1</b>	<i>I ulët</i>	<i>Në vendndodhje brenda 12 orësh</i>	<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë pas raportimit.</i>
<b>2</b>	<i>I mesëm</i>	<i>Në vendndodhje brenda 6 orësh</i>	<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 12 orë pas raportimit</i>
<b>3</b>	<i>I lartë</i>	<i>Në vendndodhje brenda 2 orësh</i>	<i>Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas raportimit.</i>

*Në rastin e ndërprerjes së punës në pajisje për më shumë se 24 orë dhe në rast se defekti i konstatuar rezulton të jetë shumë i rëndë duke ndërprerë procesin e punës për më shumë se 48 orë në ditët e ardhshme, atëherë operatori ekonomik është i detyruar të pajisë me një pajisje back-up (rezerve) për të kryer procesin normal të punës nga përdoruesi.*

*Në momentin që raportet nga sistemi i menxhimit tregojnë se niveli i bojës/tonerit ka arritur pragun Low, furnitori duhet të ketë të disponueshëm dhe të dorëzuar paraprakisht një set rezervë bojërash/toneri, në mënyrë që zëvendësimi të kryhet pa shkaktuar ndërprerje të shërbimit të printimit, ose të paktën një set rezervë bojërash/toneri për çdo tip pajisje funksionale duhet të jetë prezent në magazinën e Albcontrol.*

*Shërbimi i transportit të pajisjeve, pjesëve të këmbimit apo të konsumit, duhet të mundësohet nga operatori ekonomik me njoftim paraprak tek personi që është ngarkuar për ndjekjen e kontratës.*

## **8. FATURIMI**

*Faturimi dhe pagesa duhet të kryhet në mënyrë periodike mujore, në bazë të numrit të printimeve, fotokopjimeve, skanimeve të kryera që do të monitorohen dhe gjenerohen nga software dhe /ose nga pajisjet. Asnjë kopje e printuar/fotokopjuar/skanuar nuk duhet të kalojë pa kontabilizuar pasi duhet të monitorohet çdo sasi e printuar/fotokopjuar/skanuar me saktësi. Të gjitha pajisjet, pjesët e këmbimit/konsumit dhe tonerat përkojnë me çmimin që do të faturohet për faqe.*

## **9. AFATI I EKZEKUTIMIT**

*Afati i implementimit të paisjeve dhe sistemit të këtij shërbimi duhet të jetë jo më shumë se 1 (një) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.*

*Afati i ofrimit të shërbimit të parashikuar duhet të jetë për 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.*

III.3.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” autoriteti kontraktor ka argumentuar se “Fondi limit dhe Specifikimet teknike janë hartuar nga dy grupe të posaçme, të cilat janë ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për përlogaritjen e fondit limit, si dhe hartimin e specifikimeve të teknike, në përputhje me nenet 4, pika 38/b, nenin 34 dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, dhe nenin 76 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Specifikimet teknike janë hartuar në proporcion të drejtë me tipologjinë e shërbimit të kërkuar duke shprehur të dhënat minimale që duhen për realizimin me sukses të kontratës.*

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën e veçantë (Specifikimet Teknike) tek Dokumentat e Tenderit (D.T.)*

*Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.*

*Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e Dokumentave të Tenderit (D.T.) ngarkuar në S.P.E. e A.P.P., për shërbimet objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të L.P.P., si dhe nenit 41, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të L.P.P.. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

III.3.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.3.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.3.6 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III.3.7. Neni 36 i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të

plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i

kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në

mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 ”Për prokurimin publik” të parashtrajnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 ”Për prokurimin publik” është përafuar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim.” Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor, si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson, se fakti se nëse një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor nuk përbën një kusht sine qua non, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtar/ndërkombëtarë me reputacion.

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së Lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të

nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se: *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 ”Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ushtrojnë të drejtën e ankimit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110, pika 1 të ligjit nr.162/2020.

III.3.9.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “IN PRINT” SHPK, për modifikimin e dokumentave të tenderit, konkretisht shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” duke kërkuar modifikimin e specifikimeve teknike konkretisht lidhur me shpjeguesin e pajisjeve shumë funksionale A/3 dhe A4 me ngjyra : *pajisjsja A3/A4 45 faqe/mi, dhe pajisja A4 50 faqe/min kontestojme shpejtesine e larte per faqe/min te cilat jane kerkuar. Shpejtesite e permendura hyjne tek kategorite pajisjeve me shpejtesi te larte.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Në rastin konkret KPP gjykon, se kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi, e më konkretisht: për pajisjen shumë funksionale A3/A4 me ngjyra, për të cilën kërkon që shpejtesia të jetë  $\geq 45$  faqe/min si dhe për pajisjen shumë funksionale A4 me ngjyra për të cilën kërkon që shpejtesia të jetë  $\geq 50$  faqe/min”, janë kërkesa të cilat lidhen me funksionalitetin në tërësi të pajisjeve dhe me cilësinë e

shërbimit të kërkuar. KPP konstaton se, në procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike AK nuk ka justifikuar se si këto specifikime teknike ndikojnë në funksionalitetin e pajisjeve objekt prokurimi. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitojë përcaktime fikse apo vlera të larta, të cilat cojnë në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me këto parametra, autoriteti kontraktor duhet ti rishikojë ato duke vendosur vlera më të ulëta për sa kohë që nuk çënojnë mirëfunksionimin e pajisjeve, duke evituar parametra të larta të cilat do të kufizonin ofertimin dhe pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë.

### **Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.**

III.3.9.2 Lidhur me pretendimin e ankimuesit “IN PRINT” SHPK, dhe “Infosoft Office” SHPK për modifikimin e dokumentave të tenderit, konkretisht shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” duke kërkuar modifikimin e specifikimeve teknike konkretisht lidhur me pajisjen A3/A4 dhe A4 për kapacitetin standart të letres dhe kapaciteti maksimal i hyrjes se letres, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, si dhe të kërkojë që produktet objekt-prokurimi të jenë të cilësisë maksimale. Në rastin konkret KPP gjykon, se kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi, e më konkretisht: për pajisjen shumë funksionale A3/A4 me ngyra, për të cilën kërkon që Kapacitetin standart të letres : jo më i vogël 1.100 fletë; Kapaciteti maksimal i hyrjes se letres:5.100 flete dhe për pajisjen A4 Kapaciteti standart i letres : jo me i vogel 1.200 flete; Kapaciteti maksimal i hyrjes se letres : 2.300 flete, janë kërkesa të cilat lidhen me funksionalitetin në tërësi të pajisjeve dhe me cilësinë e shërbimit të kërkuar. KPP konstaton se, në procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike AK nuk ka justifikuar se si këto specifikime teknike ndikojnë në funksionalitetin e pajisjeve objekt prokurimi. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të evitojë përcaktime fikse apo vlera të larta, të cilat cojnë në kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me këto parametra, autoriteti kontraktor duhet ti rishikojë ato duke vendosur vlera më të ulëta për sa kohë që nuk çënojnë mirëfunksionimin e pajisjeve, duke evituar parametra të larta të cilat do të kufizonin ofertimin dhe pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë.

### **Sa më sipër pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues qëndrojnë pjesërisht.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për

*ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur. (Shërbime)”, me nr. REF-79275-03-13-2026, me objekt “Shërbim printimi”, me fond limit 12 399 500 (dymbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 02.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Albcontrol.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “IN PRINT” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur. (Shërbime)”, me nr. REF-79275-03-13-2026, me objekt “Shërbim printimi”, me fond limit 12 399 500 (dymbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 02.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Albcontrol.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur. (Shërbime)”, me nr. REF-79275-03-13-2026, me objekt “Shërbim printimi”, me fond limit 12 399 500 (dymbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 02.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Albcontrol
4. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InPrint” SHPK
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK

8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

